

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E HËNË 20 DHJETOR 2021

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhur me ligjin që kemi për shqyrtim, besoj se sot është një moment shumë i rëndësishëm për të bërë një reflektim shumë të fortë, jo thjesht dhe vetëm mbi këtë ligj, por mbi gjithçka lidhet me rendin, me Policinë e Shteti dhe ngjarjet që lidhen me të. Së pari, është shumë e qartë se situata e rendit dhe kriminaliteti qartazi po përkeqësohen vit pas viti, treguesit janë evidentë dhe për fat të keq, kronika e zezë është ajo që dominon jetën e shqiptarëve, emocionet e tyre dhe njëkohësisht destabilizimin e tyre të fortë shoqëror. Është e qartë për të tërë, se të gjitha veprimet hipokrite si aksioni spektakolar për të çkanabizuar një fshat dhe më tej për të mbjellë të tërë Shqipërinë me hashash, janë një realitet evident, i qartë për shqiptarët, por i qartë edhe për këdo tjetër që ndjek dhe monitoron Shqipërinë, duke filluar nga Departamenti Amerikan i Shtetit dhe të gjitha instrumentet e tjera ndërkombëtare, ku treguesit përkeqësohen në mënyrë të tmerrshme vit pas viti. Gjithçka që ka pasur të bëjë edhe me rifreskimin e stafit policor, ka qenë shoqëruar gjithmonë me procese jotransparente, për të pamundësuar që kuadrot vërtet më të mirë dhe më me integritet të përfshiheshin në polici, por përfshiheshin vetëm ata, kredibiliteti politik i të cilëve ishte i garantuar. Është shumë e qartë se ngjarjet e rënda që ndodhin përditë, me një fuqi zbuluese-parandaluese nga më të ulëtat, patjetër që e kanë ulur së tepërmi, për fat keq, besimin te policia, duke e parë atë, as më shumë dhe as më pak, nga një instrument që duhet të ishte një Polici e Shtetit, thjesht dhe vetëm në një polici të pushtetit, në shërbim të drejtuesve të saj.

Janë shumë të vërteta faktet që jo në pak raste policia është keqpërdorur, ka dalë nga misioni i saj, ka përdorur mjete të paligjshme në mënyrën sesi ka operuar, duke u vënë haptazi, egër dhe dhunshëm kundër qytetarëve të thjeshtë, gjithmonë në krah të paligjshmërisë së pushtetit, i cili ka dashur të realizojë qëllimet e veta abuzive, pse jo, edhe pak korruptive. Njëherazi, edhe pjesa e shëndoshë e Policisë së Shtetit, duke parë sesi silltet politika e pushtetit, automatikisht është stepur, është tërhequr, është shurdhuar, është qorruar, duke mos e bërë aspak misionin e saj. Po të vijmë te ligji, besoj për të tërë, ata që kanë pasur kurajën profesionale ta shikojnë këtë ligj në sy, shikojmë që edhe kjo është një pseudoreformë ligjore, dhe është qesharake. Sigurisht, sqima, durimi, por dhe turpi për të t'i parë ligjet si duhet nuk ekziston më, pasi një pjesë e mirë e vlerësimeve, të cilat ndodhen në ligjin e vitit 2014, me relacionin e këtij ligji janë si dy pika uji. Është e turpshme, dhe unë nuk e di sesi mund të vazhdojë të miratohet një ligj i tillë, ku në relacionin shpjegues të tij pohohet se ky projektligj ka për qëllim krijimin e një agjencie profesionale, duke u shkëputur nga 4 praktikat e trashëguara ndër vite, ku punohej si strukturë ilegale, e mbyllur, jo në shërbim të qytetarit.

Po mirë, kjo strukturë është ngritur në vitin 2014, po e njëjta maxhorancë është që e qeveris policinë dhe Ministrinë e Brendshme, si paskan punuar në gjithë këto vite? Qenka kthyer në një strukturë ndëshkuese e organizuar që vepron përtej ligjit, në mënyrë të fshehtë, në mënyrë okulte, në mënyrë partizane, në dorë të ministrit të Brendshëm dhe jo në shërbim të qytetarit? Ky fakt i pohuar me gojën e tyre e bën shumë më të rëndë situatën. Megjithatë, për ironi të fatit, nuk e dëgjova që këtij ligji t'i referohen edhe misionet ndërkombëtare, të cilat e kanë mbështetur ligjin ekzistues të miratuar në

vitin 2014, se të njëjta misione janë sot, që e kanë mbështetur ligjin në vitin 2014, dhe e kanë mbështetur fort, e kemi votuar atë ligj në atë kohë, sepse e menduam si një risi, por risia e këtij ligji, në thonjëza, është “thellimi dhe çimentimi i paranojës së Kryeministrit për të pasur çdo gjë në dorë”, se situata kulmon kur edhe emërimi apo lirimi i drejtorit të Përgjithshëm, deri te Ministri i Brendshëm, do të bëhet nga Kryeministri. Në këtë mënyrë, ju e kuptoni që vazhdojmë vetëm e vetëm në rrugën e centralizimit paranojak dhe qesharak, pse jo, jofunksional, të turpshëm njëherazi, të një Kryeministri që, për shkak të paranojave të veta, nuk beson më edhe tek ata që i emëron po vetë. Po edhe sepse ministri i Brendshëm një segment i tij është, një zgjatim i tij është.

Njëherazi, për ta vazhduar turpin edhe nga ana profesionale, në faqen 5, në pikën 2 të relacionit, që shoqëron projektligjin, justifikohen se kjo mënyrë duke u emëruar nga Kryeministri, unifikon emërimin me titullarët e institucioneve të pavarura. Por të gjithë ata që janë juristë e kuptojnë, sigurisht, nëse akoma kanë ndonjë raport me profesionin, që, nëse duan një institucion të pavarur, ja ku është Kuvendi i Shqipërisë, le ta miratojnë këtu, vota kanë plot, le ta sjellin këtu. Institucione të pavarura që emëron dhe shkarkohen nga Kryeministri!! Sigurisht, kuptohet që turpi këtu e ka humbur limitin dhe mund të shkruhet gjithçka, sepse ka një sasi votash, të cilat verbatazi, pa asnjë forcë karakteri dhe pa asnjë sens ndihme, mbështetje nga qytetarët, mund të miratojnë çdo gjë. Pra, në këtë mënyrë Kryeministri, automatikisht kthehet ministër i Brendshëm, do ta mbikëqyrë Policinë e Shtetit dhe do ta mbikëqyrë po ai Kryeministër që i ka bërë thirrje kësaj policie, që të bënte vota për Partinë Socialiste në fushatë e të mos merrej me punët e saj. Ashtu sikurse ndodh me ligjin “Për bashkëqeverisjen”, për të cilin ka ardhur një dekret sot në këtë Parlament, dhe ishte një mundësi reflektimi, ndonëse qëndrimi “grushtbashkuar” te Kryeministri, bën që ta rrezojnë edhe atë, çfarë shikojmë? Shikojmë vazhdimin e centralizimit të çmendur, paranojak dhe hysterik, sërish te duart e Kryeministrit, pasi të tërë votojnë pa asnjë forcë karakteri dhe pa asnjë forcë analize, ligje pa kuptim që nuk thonë asgjë, vetëm sa e turpërojnë Parlamentin për mënyrën sesi votohen.

Në këtë mënyrë, Agjencisë i jepet në dorë, siç e dini, edhe vetingu i policisë, i cili me gjithë debatin e shumtë, me gjithë ndryshimet e përcudnimet e papara që janë bërë, mbas miratimit fillestar të tij, edhe me mirëkuptimin opozitar në atë kohë, edhe ky zgjatim bëhet që dora e Kryeministrit të jetë edhe mbi vetingun, për t’u dhënë të kuptojnë që ai ka fatet e këtyre punonjësve për çdo gjë dhe për gjithçka. Sigurisht është qesharak, gjithashtu edhe kualiteti i Agjencisë, sepse siç e thashë edhe më lart, në vend që të rritet kualiteti i punës, i një agjencie që me demokraci ka funksione kaq të rëndësishme, që i shtohen edhe funksione të tjera, se do t’u shtohen jo pak funksione. Siç e shikoni, është parashikuar që të punësuarit të jenë vetëm me dy vjet eksperiencë. Nuk e di kush është i qetë dhe voton që shërbimi i kësaj Agjencie, me gjithë këto punë të komplikuar të ketë njerëz me 2 vjet eksperiencë. Shumë nga kolegët këtu do të kenë pështyrë edhe mbi zanatin e tyre, edhe mbi investimin e tyre profesional, kur kanë pranuar që Agjencia me tërë këto funksione të mëdha, të ketë njerëz me 2 vjet eksperiencë dhe me 3 muaj kurs.

Ky është reformim i nivelit shumë të lartë që do t’i ofrohet publikut shqiptar dhe që do të jetë njësoj i lidhur me SHÇBA-në e mëparshme. Edhe rekrutimi, kthimi i kësaj Agjencie në një agjenci me shërbim civil, ku të gjitha procedurat e rekrutimit do të bëhen sipas procedurave të Kodit të Punës, për të lehtësuar procedurat, që të hyjë atje lloj e soj militanti, sepse me dy vjet hyn i bardhë, i zi, i kuq e i verdhë, boll të mbulojë, të mos hetojë, t’i bëjë fresk pushtetit, deri në fund, sepse ndonjë turp të madh nuk ka, as për performimin profesional, as për të shkuarën e vet. Megjithatë, është fare e qartë se i gjithë morali i kësaj çështjeje, është se kjo Polici Shteti me të gjitha ligjet që pasojnë, vazhdon të transmetohet, të thellohet gjithmonë e më shumë, si polici e pushtetit. Po të pranojmë këtë ligj si të tillë, pavarësisht fatalitetit që ai votohet, thashë verbëria dhe paranojat mposhtin çdo gjë, ky ligj nuk bazohet në barazimin e pushteteve, sepse edhe OPGJ-të, që do të jenë pjesë e kësaj Agjencie,

përcaktohen nga një strukturë që varet nga Kryeministri, duke unifikuar gjithçka midis partisë në pushtet dhe shtetit, dhe duke e kthyer policinë përfundimisht në polici të pushtetit, arsye për të cilën duhet votuar kundër.